




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI
ARTEVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E ARKIVAVE

UNIVERSITETI I ARTEVE

Nr. 4314, prot., datë 30.04.2024

Nr. 644, prot., datë 14.05.2024

MARRËVESHJE
PËR
BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM AKTIVITETESH TË PËRBASHKËTA
NDËRMJET
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE
DHE
UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Në mbështetje të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, nenit 3, pika b, të Rregullores "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Drejtorisë së Përgjithshme e Arkivave", miratuar me VKM nr. 360, datë 26.04.2017 i ndryshuar, dhe në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi midis palëve:

Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, përfaqësuar nga Prof. Asoc. Dr. Ardit Bido, me adresë: Rr. "Jordan Misja", 8303, Tiranë, e-mail: dpa@arkiva.gov.al, dhe

Universitetit të Arteve, përfaqësuar nga Prof. Kastriot Çausi, krijuar me VKM-Nr. 234, datë 23.03.2011, me adresë Rr. "Bulevardi Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza" 2, 1019, Tiranë, e-mail: kontakt@artacademy.al.



Neni 1

Kjo marrëveshje rregullon marrëdhëniet midis palëve me qëllim zbatimin e projekteve të përbashkëta. Projektet në fjalë kanë si qëllim zhvillimin e aktiviteteve artistike, kulturore të përbashkëta. Projektet që do të realizojmë synojnë zhvillimin e shfaqeve të ndryshme, filmave dokumentarë, muzikës, arteve të bukura si dhe artit skenik.

Kjo marrëveshje ka si qëllim, që për arsye studimore, të sigurojë dhe të lehtësojë shërbimin për shfrytëzimin e pasurive arkivore që administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për studentët e të gjitha cikleve dhe pedagogët e Universitetit të Arteve.

Neni 2

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave merr përsipër lënien e hapësirës, jo kundrejt pagesës përveç rasteve kur aktiviteti do të jetë me pagesë, për zhvillimin e aktiviteteve, si dhe në rast nevojë, në varësi të aktivitetit, edhe të fonisë dhe banerit.

Neni 3

Universiteti i Arteve mban përgjegjësi për ruajtjen fizike dhe teknologjike të materialit që do të lihet në funksion të projekteve nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave duke e ndjekur me përgjegjësi dhe zëvendësimin e tyre në rast dëmtimi të mundshëm.

Në rast se do të zhvillohen aktivitete me pagesë, atëherë 20% e vlerës duhet të kalojë në llogarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe pjesa tjetër Universitetit të Arteve.

Neni 4

Universiteti i Arteve duhet të njoftojë Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, me shkrim ose në formë elektronike, minimumi 30 (tridhjetë) ditë para datës së aktivitetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka detyrim të konfirmojë ose jo kërkesën, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e saj.

Neni 5

Universiteti i Arteve merr përsipër të njoftojë Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave deri në 48 orë para, për anulim të mundshëm të aktivitetit. Në rast ndryshimi date, duhet të njoftojë Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave 7 (shtatë) ditë para dhe gjithmonë duhet të presë konfirmimin për datën e re.

Në rast ndryshimi të mundshëm të datës së aktivitetit (emergjence të mundshme), Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave merr përsipër të njoftojë Universitetin e Arteve, jo më vonë se 7 ditë para aktivitetit dhe të propozojë brenda këtij afati një datë të re.



Neni 6

Çdo ndryshim i kësaj marrëveshje do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se është realizuar përmes një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga të dyja palët.

Neni 7

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e firmosjes nga përfaqësuesit e palëve dhe mbetet në fuqi për 5 (pesë) vjet nga data e firmosjes.

Me përfundimin e afatit, nëse asnjëra nga palët nuk shpreh vullnetin për t'i dhënë fund, kjo marrëveshje rinovohet për një afat tjetër 5 (pesë) vjeçar.

Në rast se një nga palët dëshiron të tërhiqet nga kjo marrëveshje para afatit të përfundimit, duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër të paktën 3 (tre) muaj para.

Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi prej palëve, çon automatikisht në prishjen e saj.

Neni 8

Në rast mosmarrëveshje, palët i zgjidhin ato me negociim midis tyre, duke u udhëhequr nga parimi i bashkëpunimit dhe vullnetit të mirë.

Neni 9

Kjo marrëveshje do të mbahet në 4 (katër) kopje identike në gjuhën shqipe, dhe secila palë merr nga 2 (dy) kopje.

Palët pasi njihen me përmbajtjen e saj, me vullnet të lirë nënshkruajnë këtë marrëveshje.

PËR

DREJTORINË E PËRGJITHSHME
TË ARKIVAVE

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Prof. Asoc. Dr. Ardije Bido

PËR

UNIVERSITETIN E ARTEVE

REKTORI

Prof. Kastriot Caushi